

**AKT THEMELIMI I  
SHOQËRISË TREGTARE  
AS PROPERTIES SH.P.K  
ME SELI NË TIRANË**

Sot, më datë 25.08.2022 (dymijënjëzetedy):

- **Znj. Anxhela Seferi**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 02.07.1968, lindur në Tiranë dhe bauese në Tiranë, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e pasaportës BJ6326223.

Vendosi:

Themelimin e shoqërisë tregtare **AS PROPERTIES SH.P.K**, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Shoqërinë Tregtare **AS PROPERTIES SH.P.K**, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (në vazhdim Shoqëria). Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

**NENI 2**

**Emri i shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **AS PROPERTIES SH.P.K**

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë kryerja e çdo aktiviteti tregtar të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrja në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar në baze të legjislacionit shqiptar, siç mund të ndryshohet here pas here dhe në veçanti, por pa u kufizuar në;

- **Të zoterojë, të administrojë, të blejë, të shesë, të jap me qira, të këmbejë dhe në përgjithësi të tregtojë ose të ndërmjetësojë në tregtim e çdo pasurie të luajtshme ose të paluajtshme ose edhe në lidhje me të drejtat mbi këto pasuri. Të kryejë çdo biznes, punë ose veprimtari që lidhet me çdo lloj pasurie të luajtshme ose të paluajtshme në përgjithësi.**

Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektivin e mësipërm, çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar,

qiraje ose hipoteke, si dhe çdo veprimtari me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme që mund të konsiderohet i nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të shoqërisë.

Për ushtrim të aktivitetit të shoqërisë me gjithë ndryshimet që mund të ketë shoqëria mund të hyjë më marrëveshje partneriteti dhe bashkëpunimi me palë të tretë qofshin ente publike apo private, të marrë pjesë në procedura të ndryshme konkurrimi në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të gjitha veprimtaritë do të zhvillohen në përputhje me ligjin që rregullon ushtrimin e asaj veprimtarie. Shoqëria do të marrë të gjitha licencat dhe miratimet që mund të jenë të nevojshme për zhvillimin e veprimtarive të sipërpërmendura sipas kërkesave të ligjit të fushës.

#### **NENI 4**

##### **Selia e Shoqërisë**

**Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Thoma Avrami nr 12, Njesia Administrative nr 2, numri i pasurisë 4/234, zona kadastralë 8160, Tiranë.**

#### **NENI 5**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në vlerën prej 100,000 (njëqindmijë) lek.

Ortakët themelues të Shoqërisë zotërojnë kuotat si më poshtë:

- 1. Anxhela Seferi** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 100 % të vlerës së kapitalit themeltar të Shoqërisë të barabartë me 1 kuotë me vlerë nominale 100,000 (njëqindmije) lek.

Kapitali themeltar është investuar nga ortaku themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortaku themelues në rast të miratimit të kësaj kontrate themelimi dhe të firmosur nga ai.

#### **NENI 6**

##### **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon pas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

#### **NENI 7**

##### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve– organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët zgjidhen për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

- **Administratori i Shoqërisë do të jetë Zj. Anxhela Seferi, shtetase shqiptare, e datëlindjes 02.07.1968, lindur në Tiranë dhe bauese në Tiranë, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e pasaportës BJ6326223.**

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi

#### **NENI 8**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 9**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 10**

##### **Ligji i aplikueshëm**

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët/u themelues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 11**

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

#### **NENI 12**

## **Dispozitat përfundimtare**

Akti i Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe është në përputhje me vullnetin e lirë të themeluesit, i cili, nëpërmjet përfaqësuesve të tij e nënshkruan pa vërejtje.

## **ORTAKU THEMELUES**

**Anxhela SEFERI**

Anxhela Seferi  
Anxhela